

VENDIM
Nr. 32, datë 27.4.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 2.3.2018, “PËR LICENCIMIN E
SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LIBOHOVË”**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë, për licencim për efekt të ndryshimit të zonës së shërbimit, Komisioni Kombëtar Rregullator, konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 17, datë 2.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë”;
 - Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë iu la detyrë të aplikojë për zgjerim të zonës së shërbimit për njësitë administrative Qendër Libohovë dhe Zagorie, menjëherë pas reflektimit të tyre në QKB;
 - Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë ka aplikuar, me anë të shkresës nr. 72 prot., datë 17.4.2018, për ndryshimin e licencës për efekt të zgjerimit të zonës së shërbimit;
 - Aplikimi i shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit mbi ndryshimin e zonës së shërbimit, konkretisht:
 - sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë ka rritur kapitalin e shoqërisë duke zmadhuar vlerën e aseteve të shtuara sipas VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016;
 - dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr. 17, datë 2.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë”, ndryshohet si më poshtë:

“Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Libohovë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani